

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____.2025

“PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, ‘PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 148 “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor” ndryshohet si më poshtë:
“Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 10 për qind.”.

Neni 2

Në nenin 149 “Vlera e kompensimit”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. Shuma që kompensohet është rezultat i shumëzimit të normës së kompensimit me vlerën totale të produkteve dhe shërbimeve bujqësore, të furnizuara nga prodhuesi bujqësor, përgjatë një periudhe gjashtë mujore.”.

Neni 3

Neni 150 “Mënyra e zbatimit të skemës” ndryshohet si më poshtë:
“1. Blerësi i produkteve bujqësore, person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si, grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin, lëshon një faturë tatimore për shitësin, prodhues bujqësor për çdo furnizim mallrash dhe shërbimesh të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit, mbi të cilën aplikohet norma e kompensimit, sipas këtij ligji.
2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 101, të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit. Në faturë duhet të shënohet NIPT-i sipas nenit 147, shkronja “ç”, të këtij seksioni.
3. Kompensimi i akorduar i paguhet prodhuesit bujqësor nga administrata tatimore. Për të përfituar këtë kompensim, shitësi, prodhues bujqësor, duhet të dorëzojë në administratën tatimore, nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike, një kërkesë për kompensim, të shoqëruar me kopje të faturave të lëshuara nga blerësi i mallrave dhe shërbimeve bujqësore, si dhe numrin e llogarisë së tij

bankare. Kërkesa për kompensim paraqitet sipas periudhave të mëposhtme:

- a. brenda datës 31 Dhjetor, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit përkatës.*
 - b. brenda datës 30 Qershor të vitit pasardhës, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Korrik-Dhjetor të vitit paraardhës.*
- 4. Administrata tatimore kryen kompensimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.*

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 1 janar 2026.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI